VENDIM
Nr. 124, datë 24.9.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "CAPITAL RADIO" SUBJEKTIT: SHOQËRIA "CAPITAL RADIO" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", dhe rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Capital Radio" sh.p.k., për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "Capital Radio" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati